

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **AGJENCIA PER MENAGJIM EMERGJENT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **21432700-23-14367-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Krijimi i sitemit per menaxhim e aktiviteteve te AME dhe NJPZSH**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>ALBASOFT SH.P.K.</b>
NUI	<b>810027723</b>
Adresa	<b>Agim Ramadani 54 1/6</b>
Vendi	<b>Prishtine</b>
Kodi postar	<b>10000</b>
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Ernest Culaj</b>
Adresa elektronike	<b>ceo@albasoft.biz</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>05.05.2025</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**Krijimi i sitemit për menaxhim të aktiviteteve të AME dhe NJPZSH**

**Me datën 17.04.2024 është publikuar Njoftim për Kontratë**

**Me datën 30.04.2024 është publikuar Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara**

**Me datën 31.07.2024 po ashtu është publikuar Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara**

**Me datën 07.08.2024 po ashtu është publikuar Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara**

**Me datën 23.08.2024 është publikuar B12 Proces verbali i hapjes së Tenderëve (4).Pdf**

**Me datën 26.09.2024 është publikuar Njoftim mbi Vendimin e AK dhe Letrat Standarde 26.9.2024.pdf, ku jemi të vetmit që jemi të suksesshëm në këtë procedurë.**

**Brenda afatit ligjor janë bërë kërkesa për rishqyrtim nga: Tech Vision SHPK, Rener Shpk, PBC SHPK, CACTTUS SHPK, Infosoft System SHPK, DataPrognnet SHPK, Geo & Land SHPK, ku AK ka refuzuar kërkesat e tyre pasi që nuk ishin të përgjegjshëm.**

**Më pas brenda afatit ligjor parashtrojnë ankesë pranë OSHP-së operatorët: DataPrognnet SHPK, Geo & Land SHPK, CACTTUS SHPK dhe Arianit R. Bytyqi B.I., dhe pas një procesi të stërrzgatur OSHP e kthen në rishqyrtim lëndën.**

**Me datën 17.04.2025 AK publikon "Njoftim mbi vendimin e AK - Rivleresim 17.4.2025.pdf" me të cilin anulon procedurën me arsyetimin e mungesës së mjeteve.**

**Me datën 22.04.2025 ne si GOE bëjmë kërkesë për rishqyrtim.**

**Me datën 24.04.2025 AK refuzon kërkesën tonë për rishqyrtim.**

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☐

Jo ☒

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☒

Jo ☐

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☒

Jo ☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

**AK në refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim cek që diplomat e stafit janë në gjuhën italiane, ndërsa nuk ka bërë kërkesë për sqarime shtesë që të kemi mundësi të dorëzojmë përkthimet në gjuhën shqipe ose angleze. Ne konfirmojmë që i posedojmë këto diploma të përkthyer.**

**Gjithashtu arsye tjetër ceket që në mungesë buxheti anulohet ky aktivitet. Kjo është shkelje ku pas miratimit nga AK ka filluar procedura e prokurimit, dhe AK rrjedhimisht e ka obligim që gjatë ekzekutimit të projektit të gjejë fondet e duhura, duke marrë parasysh që është procedurë kornizë si dhe projekti zgjat 36 muaj.**

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Ne besojmë që AK ka shkelur nenet në vijim:

Neni 1 i LPP

Neni 9 i LPP

Neni 38 i RrPP

Neni 65 të LPP

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

**Bashkëngjitur faktet dhe argumentet.**

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Nuk janë vlerësuar në këtë fazë.**

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

## FAKTET DHE ARGUMENTET

### Përshkrim i shkurtër i procesit:

Bazuar në aktivitetin e prokurimit, subjekti ynë ka dorëzuar ofertën në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit. Pas hapjes së ofertave dhe vlerësimit nga Autoriteti Kontraktor, jemi shpallur fitues, meqenëse oferta jonë i përmbushte të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe administrative të tenderit.

Pas shpalljes së këtij vendimi, janë paraqitur katër ankesa nga operatorë të tjerë ekonomikë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), përkatësisht me nr: **974/24, 976/24, 980/24 dhe 995/24**. Në trajtimin e këtyre ankesave, janë realizuar ekspertiza dhe superekspertiza përkatëse nga OSHP, përmes ekspertëve të caktuar.

Fillimisht, ekspertiza e përgatitur nga z. *Kushtrim Myftari* konkludoi se operatorët ankues janë të papërgjegjshëm, ashtu siç kishte konstatuar edhe AK në vendimin e saj. Më pas, superekspertiza është përgatitur nga z. *Kujtim Bajrami* (ekspert shqyrtues) dhe z. *Ernest Kerqeli* (ekspert teknik). Këtu ka lindur thelbi i problemit: për pretendime identike, ekspertët kanë paraqitur mendime të kundërta. Ku njeri ekspert (shqyrtuesi) ka mendime subjektive të pa bazuar në fakte dhe ekspertize teknike, derisa eksperti (teknik) ofron ekspertize në baze të kriterëve të dosjes dhe dokumenteve të paraqitura nga Operatorët me oferte.

Më pas, çështja është trajtuar nga dyshja e ekspertëve Kujtim Bajrami (ekspert shqyrtues) dhe Ernest Kerqeli (ekspert teknik), të cilët në superekspertizë kanë dhënë mendime kontradiktore për të njëjtat pretendime të ngritura. Në mënyrë të veçantë, theksojmë çështjen e mosplotësimit të kërkesës për **garancionin e produktit**, ku disa nga operatorët nuk kanë ofruar **deklaratën e garancionit nga prodhuesi dhe disa të tjerë e kanë ofruar garancionin**, siç kërkohej qartë në dokumentacionin e tenderit dhe në momentin e dorëzimit të ofertës.

Në mënyrë të pakuptueshme dhe në kundërshtim me rregullat e procedurës, në pjesën teknike të trajtimit të ankesave është marrë në konsideratë mendimi i ekspertit shqyrtues, duke anashkaluar mendimin e ekspertit teknik, edhe pse ky i fundit ka ofruar analizë të qartë dhe të argumentuar mbi mospërmbushjen e kriterëve teknike nga operatorët ankues.

Duke marrë parasysh sa më sipër, i drejtohem Panelit Shqyrtues me kërkesën që:

1. Të rivlerësohen ekspertizat në mënyrë objektive dhe në bazë të dokumentacionit zyrtar të dorëzuar nga operatorët;
2. Të merret në konsideratë mendimi profesional dhe i argumentuar i **ekspertit teknik**, i cili ka konstatuar mungesën e plotësimit të kriterëve teknike nga operatorët ankues;
3. Të zëvendësohet **eksperti shqyrtues Kujtim Bajrami** me një tjetër ekspert të paanshëm, i cili do të analizojë ankesat bazuar **ekskluzivisht në faktet ligjore dhe dokumentacionin e ofruar** dhe jo në interpretime subjektive;
4. Të konfirmohet vendimi fillestar i Autoritetit Kontraktor, ku subjekti ynë është shpallur fitues në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, pasi ka përmbushur në tërësi kërkesat e dosjes së tenderit.

Ne kërkojmë që të mbrohet integriteti i procesit të prokurimit publik dhe që çdo vendim të merret mbi bazën e fakteve, ligjit dhe standardeve të barazisë në konkurrim.

## Ne vijim pretendimet ankimore.

### Pretendimi 1:

#### Diplomat

Bezuar në LPP, AK do të duhej të kërkojë sqarime shtesë sa i përket kësaj pike, ku ne konfirmojmë që i kemi diplomat e përkthyer në gjuhë zyrtare.

Këtë e konfirmon edhe eksperti në ekspertizën “Raporti\_Ekspertit\_2024 0995.pdf” faqe 30, citoj:

*“Ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohej nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument.”*

### Pretendimi 2:

#### Buxheti

Ne konsiderojmë që AK ka bërë shkelje të Nenit 8 dhe 9 të LPP.

Sipas nenit 9 të LPP-së, AK është i obliguar të sigurojë planifikim të saktë dhe të ketë fonde të garantuara përpara inicimit të procedurës. Nisja e procedurës pa fonde të sigurta, dhe anulimi më pas për mungesë të tyre, përbën shkelje të drejtpërdrejtë të këtij neni.

Për më tepër, neni 8 i LPP-së e obligon AK që të veprojë në përputhje me parimet e transparencës, përgjegjshmërisë dhe planifikimit të mirë financiar. Ky vendim bie ndesh me këto parime dhe dëmton integritetin e sistemit të prokurimit publik.

Ne si operator ekonomik kemi investuar kohë, burime dhe kosto për përgatitjen e ofertës, në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit. Vendimi i papritur për anulim na shkakton dëm ekonomik dhe penalizon konkurrencën e ndershme.

### Pretendimi 3:

#### Mungesa e deklaratës së Garancionit nga Prodhuesi, i GOE “GEO & LAND dhe Novus”

Ne si OE të përgjegjshëm ndaj kriterëve të DT-se, ju informojmë juve si Organ Shqyrtues i prokurimit se: GOE “GEO & LAND dhe Novus” sipas vendimeve, ankesave, ekspertizave shihet që nuk kanë plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit si ne vijim:

Ky GOE nuk plotëson **Garancionin** e kërkuar në dosjen e tenderit e cila është konfirmuar me fakte në superekspertizë nga Eksperti Teknik (E.K), ku eksperti në mënyrë të thjeshtë faktike tregon që pretendimi ankimor mbrojtës rreth garancionit është i PA BAZUAR, sepse kërkohej Garancioni në Ankes 1 për secilin produkt, e i njëjti nuk është përmbushur nga ky operator.

Ne vijim keni sqarimet nga ekspertet për këtë pjesë, ku eksperti teknik në bazë të fakteve e paraqet si pretendim të PA BAZUAR sepse ndër operatorët tjetër ky grup i operatorëve e ka mungesë këtë deklaratë:



#### **Pretendimi ankimor 1:**

Në Dosjen e Tenderit, për produktet e kërkuara (kompjuterë, printerë, laptopë dhe monitorë të markave të caktuara), është përcaktuar se duhet të ofrohet garanci: 3 vjet (për printerin është kërkuar 2 vjet), e cila duhet të jetë e lëshuar nga prodhuesi dhe të shoqërohet me të dhëna të projektit.

Pretendimet ankimore të OE në këtë rast mbështeten në faktin se është ofruar një dokument i nënshkruar (dokumenti 7\_2\_Specifikacion teknik\_furnizim.pdf), ku janë të cekura specifikimet e pajisjeve dhe garancioni i kërkuar, si dhe dokumenti MAF nga prodhuesi.

**Përgjigja e ekspertit profesional në pretendimin ankimor 1 :** Pretendimi i operatorit ekonomik (OE) është i bazuar, pasi eliminimi për shkak të mungesës së garancionit paraprak nuk është i justifikuar në këtë fazë të prokurimit.

Kërkesa për garancion nuk ishte kriter kualifikues, pasi që :

- Autoritetit Kontraktues në kërkesat kualifikuese në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë nuk e ka përcaktuar garancionin si kriter kualifikues .
- Garancioni është përmendur vetëm në specifikimet teknike, që do të thotë se duhet të sigurohet me dorëzimin e produktit, jo në fazën e ofertës.

#### **Përgjigja e ekspertit teknik në pretendimin ankimor 1:**

Në Dosjen e Tenderit, për produktet e kërkuara (kompjuterë, printerë, laptopë dhe monitorë të markave të caktuara), është përcaktuar se duhet të ofrohet garanci: 3 vjet (për printerin është kërkuar 2 vjet), e cila duhet të jetë e lëshuar nga prodhuesi dhe të shoqërohet me të dhëna të projektit.

Pretendimet ankimore të OE në këtë rast mbështeten në faktin se është ofruar një dokument i nënshkruar (dokumenti 7\_2\_Specifikacion teknik\_furnizim.pdf), ku janë të cekura specifikimet e pajisjeve dhe garancioni i kërkuar, si dhe dokumenti MAF nga prodhuesi.

Eksperti teknik, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofertuar dhe krahasimit me kërkesat e Dosjes së Tenderit, vlerëson se përveç autorizimit të llojit MAF ose DAF, është kërkuar qartë edhe dëshmi konkrete lidhur me garancinë e produkteve. Kjo dëshmi duhet të jetë pjesë e ofertës dhe të paraqitet në formën e një dokumenti të lëshuar nga prodhuesi, që konfirmon garancinë e kërkuar.

MAF ose DAF, megjithëse janë dokumente të rëndësishme që vërtetojnë autorizimin e ofruesit nga prodhuesi, nuk japin informacion të detajuar në lidhje me garancinë e produkteve. Prandaj, këto dokumente nuk plotësojnë plotësisht kërkesën e Dosjes së Tenderit për një dëshmi specifike të garancisë.

Dosja e Tenderit kërkon qartë një dëshmi specifike të garancisë nga prodhuesi.

**Bazuar në sqarimet e mësipërme, eksperti teknik mendon se pretendimi ankimor i OE ndaj vendimit të AK lidhur me këtë çështje është i PABAZUAR.**

Shih faktet e ekspertit teknik që i ka paraqitur në ekspertizë në lidhje me garancionin e kërkuar në DT:

Për më shumë shih se ku është kërkuar garancioni tek Ankesin nr.1 –Specifikat e Detyrueshme Teknike :

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME - FURNIZIM ME PAJISJE TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE			
Brand Name PC			
Prodhuesi	Brand Name	Copë	80
Sistem Operativ	Windows 11 Pro 64 bit supported		
Procesori	Min. Intel Core i5 (min.10core, min. 20MB cache, up to min. 4.6GHz), min. gjenerata e parafundit e procesorëve		
Memorie	Min. 16GB DDR4		
HDD	Min 1TB SSD NVMe M.2		
Kartela grafike	Minimum dy porte: HDMI + DP		
Porte	Min. 2 x USB 3.2 TypeA, Min. 1x USB3.2 TypeC perpara apo më të avancuara		
Rrjeti	Min. 1 x RJ45 Gigabit port, WiFi6 + BT5.3		
Mausi dhe tastieri	Keyboard QWERTY		
Tjera	ENERGY STAR		
Audio	Integrated sound card		
Power:	EU Standard		
Garancioni	3 vite nga prodhuesi dokument me te dhenat e projektit.		
Autorizim	MAF me te dhenat e projektit apo DAF per territorin e Kosoves.		
Brand Name Laptop			
Prodhuesi	Brand Name	Copë	40
Sistem Operativ	Windows 11 Pro 64 bit supported		
Procesori	Min. Intel Core i7, (min.10cores, min. 12MB cache, up to 5GHz), min. gjenerata e parafundit e procesoreve		
Memorie	Min 16GB DDR4		
Disku	min.512 GB SSD M.2		
Kartela grafike	Integrated UHD Graphics		
Monitor	Min. 15", 1920x1080 IPS,		
Porte shtesë	Min. 1 x USB 3.2, 1x USB 2.0, 1 USB Type C, HDMI or DisplayPort		
Rrjeti:	min FullHD camera, HD Audio speakers, Dual integrated microphone		
AV	min HD camera, HD Audio speakers, integrated microphone		
	AC Included + BAG (e njejt me brendin e Laptopit)		
Tjera	ENERGY STAR		
Keyboard&Touchpad	Keyboard NumberKeys, QWERTY		
Garancioni	3 vite nga prodhuesi dokument me te dhenat e projektit.		
Autorizim:	MAF me te dhenat e projektit apo DAF per territorin e Kosoves.		



#### **Pretendimi 4:**

**Kerkesat teknike ( Metodologjia ) ne mungese 3 Modulet ne oferten e GOE “GEO & LAND dhe Novus”**

Ne kete pike nuk plotesojne 3 Modulet e pjeses se Metodologjise e cila eshte e kerkuar te dorezohet ne teresi ne dokumentet perberese te tenderit si:

**Kerkesa ne dosje:**

<b>7. OE duhet të ofrojë propozimin teknik dhe metodologjinë në lidhje me realizimin e projektit, e cila duhet të përmbushë në tërësi kërkesat e specifikimeve teknike.</b>	<b>7.Përshkrimi i propozimit teknik dhe metodologjisë për zhvillimin e aktiviteteve përputhje me kërkesat.</b>
---	--

Gjithashtu, vendimi nga AK per kete pjese:

<p><b>Ju keni prezantuar përshkrimin teknik te metodologjisë por i njëjti nuk është konform Aneksit nr. 1 te FDT nuk plotëson kriterin pasi e kërkuar pasi që mungon.</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>➤ <b>Mungon pjesa 4.11 (Historia, versioni i te dhënave dhe gjurmimi i aktiviteteve).</b></li><li>➤ <b>Mungon pjesa 4.12 (Krijimi i aplikacionit mobil).</b></li><li>➤ <b>Mungon pjesa 4.20 (Moduli i historizmit dhe verzionizimit te dhënave operative).</b></li></ul>
--

Pra nese nuk eshte e perfshire ne teresi eshte e manget dhe jo sipas kriterit ne dosjen e tenderit, derisa kjo kurrsesi nuk duhej lejuar te kalohej nga Paneli apo Eksperti sepse me kalimin e ketij kriteri apo kriterëve te tjera te DT-se i bie nderhyrje ne kerkesat kriteret e autoritetit. Per keto kerkesa Operatoret perfshire edhe ne kemi pasur mundesine e sqarimeve shtese me kohe, ndersa pas ofertimit gjithqka qe ndryshon permben ndryshim oferte sipas LPP-se, perveq rasteve ku lejon ligji per sqarime shtese, andaj do duhej qe kjo te trajtohej ne menyre jo diskriminuese dhe te shiqohet oferta dhe dosja e tenderit nese oferta ploteson kriteret e dosjes se tenderit.

**Ne vijim shpjegimi nga ekspertet, per kete pike:**

#### **Pretendimi ankimor 2:**

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të ofrojë propozimin teknik dhe metodologjinë në lidhje me realizimin e projektit, e cila duhet të përmbushë në tërësi kërkesat e specifikimeve teknike, duke ofruar si dëshmi propozimin teknik, përshkrimin teknik dhe metodologjinë për zhvillimin e aktiviteteve në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Pretendimet ankimore të OE kundrejt vendimit të AK për mos përputhje të këtyre kërkesave në këtë rast mbështeten në faktin se propozimi teknik i ofertuar (dokumenti 5\_1\_Propozimi teknik.pdf), përkatësisht deklarimi: "Është me rëndësi të deklarohet, që ne do të realizojmë të gjitha kërkesat sipas termave të referencës duke ju përmbajtur në tërësi kërkesave të kontratës. Ky dokument ka një qëllim sqarues vetëm për nga aspekti i qasjes, metodologjisë dhe teknologjisë që do të përdoret." (shih faqe 7, dokumenti 5\_1\_Propozimi teknik.pdf).

#### **Përgjigja e ekspertit teknik në pretendimin ankimor 2:**

Eksperti teknik, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofertuar dhe krahasimit me kërkesat e Dosjes së Tenderit, përkatësisht ANEKS 1, mendon se në aspektin tekniko-profesional trajtimi i kësaj çështjeje ka elemente subjektive vlerësimi, siç është cekur edhe në ekspertizën e mëparshme të ekspertit teknik. Megjithatë, lidhur me çështjet kontestuese të AK kundrejt propozimit të Operatorit Ekonomik, mendoj se:

##### **1. Pjesa 4.11 - Gjurmimi i Aktiviteteve**

- Kërkesa: Sistemi duhet të mundësojë historinë dhe versionimin e të dhënave, si dhe gjurmimin e aktiviteteve nga përdoruesit e ndryshëm, të klasifikuar sipas roleve dhe autorizimeve.
- Propozimi: Propozimi teknik i Geo&Land dhe NOVUS sh.p.k përmend mekanizma për menaxhimin e aktiviteteve dhe regjistrimin e detajeve të projekteve, por nuk ofron një përshkrim të qartë dhe të detajuar për gjurmimin specifik të aktiviteteve të përdoruesve siç kërkohet në specifikacion (faqe 37, dokumenti 5\_1\_Propozimi teknik.pdf).

Sistemi ofron monitorim të përgjithshëm, por nuk specifikon gjurmimin e detajuar të çdo aktiviteti siç kërkohet.

##### **2. Pjesa 4.12 - Krijimi i Aplikacionit Mobil**

- Kërkesa: Zhvillimi i një aplikacioni mobil për iOS dhe Android, që mundëson regjistrimin e të dhënave në terren dhe integrimin me GIS.

- **Propozimi:** Propozimi teknik (faqja 33, dokumenti 5\_1\_Propozimi teknik.pdf) përfshin një seksion për krijimin e aplikacionit mobil, ku specifikohet se aplikacioni do të mbështesë regjistrimin e gjendjes së rrugëve, lokalizimin hapësinor dhe ngarkimin e fotografive.

Aplikacioni mobil mbulon kërkesat thelbësore.

### 3. Pjesa 4.20 - Moduli i Historizimit dhe Versionizimit të të Dhënave Operative

- **Kërkesa:** Sistemi duhet të ruajë historinë dhe versionet e të dhënave operative, duke regjistruar çdo ndryshim me timestamp për të mundësuar auditimin dhe rikthimin e versioneve të mëparshme.
- **Propozimi:** Në propozimin teknik, nuk është gjetur asnjë përshkrim specifik i modulit për historizimin dhe versionizimin e të dhënave operative.

**Kjo kërkesë nuk është trajtuar qartë në dokumentin e propozimit teknik.**

Megjithatë, mendoj se është në diskrecionin e AK çështja e trajtimit të këtij pretendimi dhe marrja në konsideratë e deklaratës (faqe 7).

Bazuar në sqarimet e mësipërme, ekspertit teknik mendon se pretendimi ankimor i OE andaj vendimit të AK lidhur me këtë çështje **është pjesërisht i pa bazuar.**

#### **Pretendimi 5:**

**Kerkesat teknike ( Produkti Cisco ) i deklaruar si mosplotesim nga vete GOE “GEO & LAND dhe Novus”**

Sipas vendimit te fundit te autoritetit kontraktues dhe faktit te paraqitur shihet qe ky GOE nuk kane plotesuar kerkesen rreth produktit CISCO i cili nuk ploteson kerkesen per WiFi.

#### **Pretendimi 6:**

**Mungesa e deklarates se Garancionit nga Prodhuesi, i GOE “Cactus & BNT Electronics”**

OE Cactus sipas vendimeve, ankesave, ekspertizave shihet qe nuk kane plotesuar kerkesat e dosjes se tenderit ( Garancionin e produkteve) si ne vijim:

Ky GOE, nuk plotesojne Garancionin e kerkuar ne dosjen e tenderit e cila eshte konfirmuar me fakte ne superekspertize nga Eksperti Teknik (E.K), ku eksperti ne menyre te thjeshte faktike tregon qe pretendimi ankimor mbrojtës rreth garancionit eshte i **PA BAZUAR**, sepse kjarte kerkohet Garancioni i secilit nga produktet ne Ankes 1,derisa nga te njejtit nuk eshte permbushur ky kriter per Garancion.

**Ne vijim sqarimi nga eksperti ne menyre faktike rreth garancionit:**



**Pretendimi ankimor** : Në këtë pretendim ankimor, OE ankues pretendon se AK-ja e ka eliminuar për shkak të mungesës së garancioneve paraprahe për produktet e kërkuar, ku këtë veprim të AK-s, OE ankues e vlerëson se është në kundërshtim me nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, që kërkon një trajtim të drejtë për të gjithë operatorët ekonomikë. Garancioni për produkte kërkohet të jepet në fazën kur bëhet porosia, pasi është siguruar kontrata dhe jo më parë. Në këtë fazë të procesit, kërkesa për garancione paraprahe është e pajustificuar dhe vendos operatorët ekonomikë në një pozitë të padrejtë

**Përgjigja e ekspertit në pretendimin ankimor** : Pretendimi i operatorit ekonomik (OE) është i bazuar, pasi eliminimi për shkak të mungesës së garancionit paraprahe nuk është i justifikuar në këtë fazë të prokurimit.

**Kërkesa për garancion nuk ishte kriter kualifikues, pasi që :**

- Autoritetit Kontraktues në kërkesat kualifikuese në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë nuk e ka përcaktuar garancionin si kriter kualifikues .
- Garancioni është përmendur vetëm në specifikimet teknike, që do të thotë se duhet të sigurohet me dorëzimin e produktit, jo në fazën e ofertës.

**Përgjigja e ekspertit teknik në pretendimin ankimor I:**

Pas administrimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të lidhur me pretendimet ankimore të paraqitura nga OE kundër vendimit të AK, eksperti teknik vlerëson si vijon:

Pretendimet ankimore me numër 980/24 lidhen me çështjen e garancisë për produktet e ofruara, e cila është kërkuar në kuadër të Dosjes së Tenderit (DT), konkretisht në specifikimet teknike.

Në DT, për produktet e kërkuara (kompjuterë, printerë, laptopë dhe monitorë të markave të caktuara), është përcaktuar se duhet të ofrohet **garanci: 3 vite** (për printerin është kërkuar **2 vite**), e cila duhet të jetë e lëshuar nga prodhuesi dhe të shoqërohet me të dhëna të projektit.


Pretendimet ankimore të OE-së në këtë rast mbështeten në faktin se është ofruar një dokument MAF (Manufacturer Authorization Form) ose DAF (Distributor Authorization Form) nga prodhuesi, duke theksuar se garancia mund të sigurohet në rast të realizimit të porosisë.

**Eksperti teknik**, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofertuar dhe krahasimit me kërkesat e DT-së, vlerëson se përveç autorizimit të llojit MAF ose DAF, **është kërkuar qartë** edhe dëshmi konkrete **lidhur me garancinë e produkteve**. Kjo dëshmi duhet të jetë pjesë e ofertës dhe të paraqitet në formën e një dokumenti të lëshuar nga prodhuesi, që konfirmon garancinë e kërkuar. MAF ose DAF, megjithëse janë dokumente të rëndësishme që vërtetojnë autorizimin e ofruesit nga prodhuesi, nuk japin informacion të detajuar në lidhje me garancionin e produkteve. Prandaj, këto dokumente nuk plotësojnë plotësisht kërkesën e DT për një dëshmi specifike të garancionit. DT kërkon qartë një dëshmi specifike të garancionit nga prodhuesi.

Bazuar në sqarimet e mësipërme, eksperti teknik mendon se pretendimet ankimore të OE-së ndaj vendimit të AK-së lidhur me këto çështje **janë të pabazuara**.

### Pretendimi 7:

Mungesa e stafit për plotësimin e kriterëve të dosjes së tenderit nga GOE “Cactus & BNT Electronics”



Pra sipas ankesave dhe ekspertizave dhe paneleve, shihet kështu që pretendimet ankimore rreth stafit të GOE “Cactus & BNT Electronics” shihet që nuk plotësohen dhe gjithashtu konfirmohen nga ekspertet.

### Pretendimi 8:

#### Ndërrim i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në të drejtën tonë për një trajtim të drejtë, të paanshëm dhe profesional të ankesës së parashtruar nga kompania jonë në lidhje me aktivitetin e prokurimit, kërkojmë me këtë shkresë ndërrimin e ekspertit shqyrtues aktual të ankesës, për arsyet që vijojnë:

#### I. Shkelje të pozitës zyrtare dhe mosrespektim i parimeve të paanshmërisë

Gjatë trajtimit të ankesës sonë, kemi vërejtur veprime dhe qëndrime nga eksperti shqyrtues të cilat:

Ka treguar qasje të njëanshme dhe favorizuese ndaj OE jofitues që nuk i plotësojnë kriteret, duke mos marrë parasysh provat dhe argumentet tona thelbësore dhe dokumentet e ofertuara;

Është jashtë standardeve profesionale, përfshirë interpretimin selektiv dhe të gabuar të dispozitave të LPP-së;

Në disa raste, janë shprehur qëndrime të qarta subjektive, që komprometojnë besimin në paanshmërinë dhe integritetin e procesit shqyrtues.

#### II. Bazë ligjore për kërkesën

Sipas nenit 8 të LPP-së, si dhe parimeve themelore të shqyrtimit administrativ dhe të së drejtës për proces të rregullt ligjor, çdo palë ka të drejtë që ankesa e saj të shqyrtohet nga persona profesionalë, të pavarur dhe të paanshëm.

Gjithashtu, çdo konflikt interesi ose perceptim i mungesës së objektivitetit cenon drejtpërdrejt ligjshmërinë dhe besueshmërinë e vendimit përfundimtar.

### III. Kërkesa

Duke u bazuar në të gjitha sa më sipër, kërkojmë që të ndërmerren masa për zëvendësimin e ekspertit shqyrtues aktual me një tjetër ekspert profesional dhe të paanshëm, në mënyrë që të garantohet një shqyrtim i drejtë dhe në përputhje me ligjin.

Jemi të gatshëm të ofrojmë prova shtesë nëse kërkohet dhe presim që kjo kërkesë të trajtohet me seriozitet dhe prioritet.

*Nuk kemi asgjë kunder ekspertit shqyrtues, mirepo ne kërkojmë te drejten tone ligjore per te mbrojtur oferten tone dhe te kemi nje ekspertize te bazuar ne fakte !*

Kerkojme nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, qe te beje nje vleresim te drejte jo diskriminues ne baze te fakteve relevante, te beje anulimin e **vendimit te Autoritetit te dates 17.04.2025**, dhe aktiviteti i prokurimit te kthehet ne **Ri-Vleresim** dhe gjate rivleresimit Autoriteti te merr nje vendim te drejte dhe te shpallemi fitues si oferte e pergjegjshme ndaj kriterëve te DT-së